



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:192187

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589636

KPPP.nr. 1447/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Aktiv Sh.p.k., me numër unik identifikues 810197279, dhe me seli në Drenas, rr. "Jasharajve" nr. 27, kundër debitorit D.L. B.I, me numër të biznesit 81151498 dhe me seli në Malishevë, Bajë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Jeton Osmani nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 581/2023 i datës 02.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Curri nga Gllogoci, jashtë seancës me datën 18.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit D.L. B.I, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 581/2023 i datës 02.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Curri MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Aktiv Sh.p.k., me datë 02.08.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 581/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr.178-20-210-009-21 e datës 14.05.2021; Faturës nr.194-20-210-009-21 e datës 21.05.2021; Faturës nr.198-20-210-009-21 e datës 24.05.2021; Faturës nr. 205-20-210-009-21 e datës 26.05.2021; Faturës nr.207-20-210-009-210 e datës 26.05.2021; Faturës nr.209-20-210-009-21 e datës 26.05.2021; Faturës nr.204-20-210-009-21 e datës 26.05.2021; Faturës nr.212-20-210-009-21 e datës 27.05.2021; Faturës 217-20-210-009-21 e datës 02.06.2021; Faturës nr.218-20-210-009-21 e datës 02.06.2021; Faturës nr.229-20-210-009-21 e datës 05.06.2021; Faturës nr.228-20-210-009-21; Faturës nr.227-20-210-009-21 e datës 05.06.2021 me të cilin e

ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 3,679.49 EUR, me kamatë ligjore prej 8 % deri në përmbushjen definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet e përbarimit sipas tarifës së përbaruesve.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përbarimor me arsyetim se kërkesa e kreditorit për të cilën është lejuar përbarimi sipas faturave të lartcekura është e palejuar, e parakohshme dhe e pabazuar, si dhe urdhri i lartcekur nuk i përmbushë kushtet e parapara me LPP dhe si i tillë duhet të shfuqizohet pasi që fatura nuk i përmbushë tiparet e dokumentit të besueshëm sipas ligjit, pasi që të njëjtat nuk i ka pranuar asnjëherë debitori. Pastaj ka theksuar se urdhri përbarimor P.nr. 581/23 i datës 02.08.2023 i lëshuar nga Përbaruesi Privat nuk i përmban të dhënat e nevojshme sipas nenit 43 par.2 të LPP, pasi që nuk tregohet fare se në bazë të cilit dokument të besueshëm caktohet përbarimi, pastaj kredinë e cila duhet të paguhet nga debitori, mjeti dhe objekti i përbarimit, afati i zgjidhjes së kredisë e as të dhëna të tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri për Përbarim P.nr. 581/23 i datës 02.08.2023 i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur Curri, si dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguaj debitorit të gjitha shpenzimet e kësaj procedure përbarimore.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit të pabazuar dhe të pa argumentuar me arsyetim se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se faturat nuk janë pranuar nga ana e tij, pasi që secila faturë e përmban nënshkrimin e pranimin të debitorit dhe rrjedhimisht pranimi i faturës nënkupton pranimin e borxhit. Kreditori ka theksuar se prapësimi është bërë vetëm për zvarritje dhe prolongim të procedurës pasi që ai nuk ka dorëzuar asnjë provë lidhur me prapësimin e tij. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri i lejuar nga përbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së,

përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se fatura nr.178-20-210-009-21 e datës 14.05.2021; fatura nr.194-20-210-009-21 e datës 21.05.2021; fatura nr.198-20-210-009-21 e datës 24.05.2021; Fatura nr. 205-20-210-009-21 e datës 26.05.2021; fatura nr.207-20-210-009-210 e datës 26.05.2021; fatura nr.209-20-210-009-21 e datës 26.05.2021; fatura nr.204-20-210-009-21 e datës 26.05.2021; fatura nr.212-20-210-009-21 e datës 27.05.2021; fatura 217-20-210-009-21 e datës 02.06.2021; fatura nr.218-20-210-009-21 e datës 02.06.2021; fatura nr.229-20-210-009-21 e datës 05.06.2021; fatura nr.228-20-210-009-21 dhe fatura nr.227-20-210-009-21 e datës 05.06.2021, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjen se faturat e lartcekura i janë bashkëngjitur propozimit për përmbardim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, e po ashtu janë pranuar me rregull nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit i pasqyruar tek pranuesi i secilës faturë, andaj si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbardimit pasi që janë të përshtatshme për përmbardim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të ngritura me prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë siç kërkohet me nenin 69.4 të LPP-së për vërtetimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1447/23, datë 18.04.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komeriale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.